



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ 01/2020, për identifikimin, konfirmimin dhe votimin e personave të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19, janë në karantinë shtëpiake dhe personave të cilëve u është caktuar masa e vetëizolimit, si dhe kërkesës të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve e datës 26.11.2020, për lejimin e votimit me kusht të personat e infektuar me COVID-19, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën Podujevë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 27.11.2020 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet kërkesa e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Podujevë, për lejimin e votimit me kusht për personat e infektuar me COVID-19, dhe personat të cilëve ju është caktuar masa e vetëizolimit, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 29 nëntor 2020.
- II. Votuesit të cilët për shkak të testimit pozitiv me COVID-19, janë në karantinë shtëpiake dhe personat të cilëve ju është caktuar masa e vetëizolimit, ju lejohet votimi me kusht.
- III. Obligohet KKZ-ja në Podujevë se votuesit të cilët për shkak të testimit pozitiv me COVID-19, janë në karantinë shtëpiake dhe personat të cilëve ju është caktuar masa e vetëizolimit nuk do të ju shënjohet (vulokset) emri në Listën Përfundimtare të Votuesve.
- IV. Obligohet Sekretariatit i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2020, për identifikimin, konfirmimin dhe votimin e personave të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19, janë në karantine shtëpiake dhe personave të cilëve u është caktuar masa e vetë izolimit, Komisioni Komunal Zgjedhor ka kontaktuar me Shtabin Emergjent Komunal për parandalimin e COVID 19.

Shtabi Emergjent Lokal për parandalimin e COVID -19, në bazë të nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2020, është i obliguar që të siguroj listën me të dhënat e votuesve të cilëve u është caktuar masa e izolimit, me të dhënat siç janë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal të identifikimit, vendbanimin dhe numrin kontaktues të telefonit të personit të infektuar.

Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Podujevë nga Shtabi Emergjent Lokal për parandalimin e COVID-19, i është dërguar lista e personave të cilët janë të identifikuar pozitiv me COVID-19, mirëpo në këtë listë mungojnë disa të dhëna siç janë: datëlindja e plote dhe numri personal i identifikimit.

Andaj, për arsye të mungesës së të dhënave të sakta për identifikimin e personave me COVID-19, u vendos si dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 27.11.2020

Kryetarë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

